

## **Grimca Krishtlindje**

### **Gëzuar Krishtlindjen!**

Uroji Gëzuar Krishtlindjen katër personave më simpatikë që ke afër. Nëse je këtu për herë të parë, shijoje këtë festim! Çdo të diel bëjmë festime të tilla, kështu që të presim të festosh me ne. Eja me miqtë e tu!

A e ke dëgjuar më parë historinë e Krishtlindjes? Kush e di përmendësh këtë histori? Kush e ka dëgjuar disa herë? Kush po e dëgjon për herë të parë sot?

Kur shikon me detaje zbukurimet e qytetit, do të gjesh që ndër vite i janë shtuar gjëra festës së Krishtlindjes, sikurse ndodh edhe me ditëlindjet tona.

Për mua, ditëlindja e parë që mbaj mend ka qenë kur isha 6 apo 7 vjeç, i bie 1982 ose 1983. Kam marrë si dhuratë ditëlindjeje 2 vezë të skuqura. Unë jam rritur me 5 motra, ishim 6 fëmijë. Të tjerët kishin nga 1 vezë, unë që kisha ditëlindjen kisha 2 vezë të skuqura dhe një puthje në faqe nga mami. Më pas, duke kaluar vitet, duke u shtuar gjërat.

Po ditëlindja e Jezusit, a e di si është festuar? Në fakt, deri në vitin 354 mbas Krishtit, nuk është festuar Krishtlindja. Madje në këtë kohë të vitit ishte një festë romake pagane, festa e Dimrit. Festohej dimri i ri, sikurse është festa e Verës më 14 mars për ne.

Por në vitin 313, Roma u shpall kryeqytet i krishterë dhe nga ajo kohë të gjithë filluan të jetonin sipas parimeve të Shkrimit dhe, rreth 40 vjet më pas, e zëvendësuan festën e dimrit me festën e Krishtlindjes.

Dhe sot, festa e Krishtlindjes është një kohë gëzimi dhe bujarie në të gjithë botën.

*Dikush tha: Pse e festoni Krishtlindjen, kur Bibla ka të saktë vetëm kohën kur Jezusi vdiq dhe u ringjall, por nuk ka datë kur lindi ai?*

A e dini se kryqi ishte mjet ndëshkimi, i përdorur për herë të parë nga Aleksandri i Madh për të dënuar dikë? Krishti vdiq në atë kryq dhe sot kryqi, që ishte mjet dënimi dhe mallkimi, është kthyer në simbol shprese. Para se të vdiste Jezusi në kryq, askush nuk vendoste kryq diku. Por pasi ai vdiq dhe u ringjall, kryqi u kthye në simbol jete.

Kështu është edhe Krishtlindja. Pavarësisht se në cila datë ekzakte lindi Krishti, kjo është koha, është muaji kur kujtojmë dashurinë dhe bujarinë e Perëndisë. Ajo që dimë është se Jezusi lindi nga virgjëresha Mari. Erdhi për të na pajtuar me Perëndinë dhe që të shikonim se si ishte Perëndia.

Por, si çdo ditëlindje, edhe Krishtlindja ka ardhur duke iu shtuar gjëra. Për shembull, pema e Krishtlindjes u përdor për herë të parë në shekullin e 16-të. Santa ose Babagjyshi ishte një i krishterë i pasur, Shën Nikolla, që iu jepte dhurata njerëzve në nevojë dhe më vonë u kthye në traditë nga të krishterët e tjerë. Në vitin 1930, Babagjyshin e vendosi Coca-Cola në reklamat e saj dhe ia ndryshoi kostumin nga kuq dhe jeshil në kuq dhe të bardhë. Në shekullin e 4-t janë shkruar dhe kënduar këngët e para për Krishtlindje, ndërsa në kishë filluan të këndohen në vitet 1800 e ca. Dekorimet e ndryshme, çorapja e madhe në mur, brirët e drerit janë shtuar më vonë, fillimisht në Holandë.

Dhe janë të bukura, janë festive, POR nuk janë thelbi i Krishtlindjes. Thelbi i Krishtlindjes është Krishti që ka ditëlindjen.

Shiko se Krishtlindja e parë nuk ishte aq shumë festive. Madje kishte shumë tensione, shumë druajtje, shumë shqetësime, pagjumësi. Në Krishtlindjen e parë është përdorur tri herë shprehja "Mos druaj, mos ki frikë":

- **Marisë:** Engjëlli i tha: "Mos ki frikë, Mari..." (Luka 1:30)
- **Jozefit:** Një engjëll i Zotit i tha: "Jozef, bir i Davidit, mos ki frikë..." (Mateu 1:20)
- **Barinjve:** Engjëlli u tha atyre: "Mos druani..." (Luka 2:8-10)

Sot lajmi i lindjes së Jezusit është lajm i mirë, lajm i gëzuar, dhe ne festojmë. Por, kur lindi Jezusi, në fillim ata që e rrethonin nuk ndjenin fare gëzim; madje ishin shumë të merakosur: Maria, Jozefi, barinjtë, Herodi.

Në fakt, çdo njeri ka shqetësime të ndryshme në momente të ndryshme të jetës. Disa i tregojnë hapur, disa jo, por të gjithë kanë:

Disa mund të kenë shqetësime që kanë të bëjnë me të ardhmen, në lidhje me familjen, punën, shkollën, fejesën, martesën, lidhjen.

Disa kanë merakun: *po ta dinë njerëzit si jam unë në të vërtetë, a do të më pëlqejë njeri, a do të më mbajnë afër?*

*A ka rëndësi jeta ime? Po të mos vij, a do ndihet mungesa ime? Po të iki në*

*Gjermani apo diku jashtë, a do e ndjejë dikush mungesën time apo jam i padukshëm?*

*Po ta marrin vesh të gjithë çfarë kam bërë, a do më dojë ndonjëri? A më vlerëson njeri apo vetëm kanë interes ndaj meje?*

*A do arrij atë që dua në kohë apo s'do e arrij fare?*

### **Çfarë Shqetësimesh të Mundojnë apo të Bezdisin Ty Këtë Krishtlindje?**

Për moshat e mëdha, merakun është se mos vdesin të vetmuar, sepse i kanë fëmijët larg.

Mesazhi i Perëndisë në këto kohë Krishtlindjesh është shumë i veçantë, sepse Perëndia thotë:

#### **Mos Druaj, Unë Jam me Ty!**

Do të shikojmë pjesë nga Krishtlindja me një këndvështrim tjetër, *si t'i mposht shqetësimet e mia dhe të bëj atë që do Perëndia.*

#### **Si i Përjetuan Frikërat dhe Shqetësimet Personat e Krishtlindjes së Parë**

Do të shohim hapa praktike për të eliminuar shqetësimet tona.

Çfarë Shqetësimesh Kishte Maria:

#### **S'jam Person i Përshtatshëm për Këtë Punë**

Perëndia i shfaqet kësaj vajze në një vend të vogël, të varfër, dhe një engjëll i thotë: "Perëndia po mban premtimin që e ka dhënë mijëra vite më parë. Perëndia do të vijë në tokë në formën e një foshnjeje, Ai do të jetë Mesia i premtuar. Perëndia do të marrë formën e njerëzve. Dhe, meqë ra fjala, ti do të jesh nëna e këtij fëmije."

#### **Mari, Perëndia të Ka Zgjedhur Ty!**

Pse u ndje e papërshtatshme për këtë gjë Maria?

- Ishte shumë e re, adoleshente.
- Ishte e fejuar me Jozefin. Si do t'ia shpjegonte të fejuarit që është shtatzënë, por jo prej tij?

- Ishte e virgjër, s'ka lindur më parë.
- Fëmija do të jetë fëmijë i Perëndisë. Meraku që ke të bësh me punë të Perëndisë do të frikësonte çdo person. Do të rrisë fëmijën e përsosur, por ajo s'ka përvojë, jo më ta rrisë të përsosur.
- Si do t'ia shpjegonte mamit dhe shoqeve këtë muhabet.

Për ato që janë nëna, imagjino që vjen goca jote adoleshente dhe të thotë: "O ma, të betohem për kokën e babit që nuk kam bërë seks me askënd por kam ngelur pak shtatzënë dhe babai i fëmijës është Perëndia."

A do ta besojë po të thoshte vajza jote këtë gjë? "Pupupu na nxive faqen, nga fisi i tyt eti ke ngjarë, nga hallat ke ngjare, se fisi jonë është qelibar, s'na ka dal një llaf."

Dhe ajo duhet të udhëtonte në muajin e 9-të të shtatzënisë me gomar dhe duhet ta lindte vetëm në një kasolle, pa kushtet e duhura, pa ndihmën e mamisë, doktoreshës, as mamin s'do e kishte afër, madje as vjehrrën ... në raste të tilla edhe vjehrra është goxha ndihmë.

**Luka 1:30-34** *'Dhe engjëlli i tha: "Mos ki frikë, Mari, sepse ke gjetur hir para Perëndisë. Dhe ja, ti do të mbetesh shtatzënë dhe do të lindësh një djalë, dhe do t'ia vesh emrin Jezus. Ai do të jetë i madh dhe do të quhet Biri i Shumë të Lartit; dhe Zoti Perëndi do t'i japë fronin e Davidit, atit të tij; dhe do të mbretërojë mbi shtëpinë e Jakobit përjetë, dhe mbretëria e tij nuk do të ketë kurrë të sosur". Dhe Maria i tha engjëllit: **"Si do të ndodhë kjo, përderisa unë nuk njoh burrë?"**'*

*Mari, ti je me fat, ti je zgjedhur ndër miliona gra.*

*Ajo nuk tha: "O sa mirë, jam zgjedhur Miss Universi."*

*Jo, jo, ajo tha: "Si do të ndodhë? Unë s'jam person i përshtatshëm, personi i duhur, kjo është shumë gjë e madhe. Si do të ndodhë? Ore engjëll, mos ke ngatërruar derë? Mos u nise për te kati i pestë dhe ndalove gabimisht te kati i katërt? Sepse unë s'besoj që jam personi i duhur."*

Edhe Jozefi u përball me shqetësimet e tij. Por të tjera shqetësime, ai kishte hallin: *çfarë do të thotë bota, çfarë do të thonë të tjerët?*

## **Çfarë Thonë të Tjerët? A Janë Dakord Ata?**

Si te filmi “14 vjeç dhëndër”, *çfarë do të thotë bota?*

Ta themi troç, nuk e kishte të lehtë biri i botës.

Ja e zëmë je ti Jozefi dhe të thotë e fejuara: “Zemër, unë kam ngelur pak shtatzënë,” dhe ti e di si drita e diellit që s’ke bërë gjë me të.

Prit, prit, ajo të thotë: “Kam ngelur shtatzënë me Perëndinë. Prandaj fëmija do të quhet Biri i Perëndisë.”

Kush është i fejuar këtu, imagjino ta thotë e fejuara jote këtë gjë.

“Po mo rrush, po, ashtu është, por do e shohim këtë punë.”

Të njëjtën gjë përjetoi edhe ai.

Si do t’ia thotë Jozefi çunave të fshatit? Se fshati një dorë është, nuk kanë Facebook as Instagram, por e kanë marrë vesh të gjithë se çfarë ka ndodhur. Jozefi ka turp të shkojë te kafja e lagjes se do e pyesin: “Si e ke të fejuarën?” dhe s’do dijë çfarë t’u thotë.

Nuk shkon dot te zgara e lagjes me çunat, as për kalçeto se mund t’i bëjë ndonjëri pyetje të sikletshme.

Te berberi jo e jo, se ata e marrin vesh të parët çdo gjë që ndodh në lagje.

A mund ta imagjinosh sikletin, turpin, poshtërimin që ka ndjerë Jozefi në ato ditë?

Komshinj që thonë: “Alamet çuni, me zanat, me biznes por i hodhi trutë e gomarit ajo çupa. Po ky paska qenë rrotë fare, ne e dinim për çun të zgjuar. Po i besoi këto gjëra Jozefi, unë s’do e blej kompletin e dhomës, as kuzhinën ose tavolinën e bukës, asnjë mobilje te ai.”

Se Jozefi ishte zdrukhtar.

Fjalët vinin vërdallë, “Si ia hodhi e fejuara sy për sy. Dukej një çikë ashtu ajo Maria, me ato fotot që hidhte në Instagram, nuk la vend pa shkuar me shoqet, me ato xhinset e ngushta, me ato kaçurrelat.”

Por Jozefi ishte çun shumë i mirë. Bëri plane si ta prishte fejesën pa e marrë vesh njeri: “Zemër, ti e di se sa fiksim të kam, ti ke qenë gjithmonë më e bukura e fshatit por kjo që thua s’durohet, boll u talle me mua. Ma kthe unazën e fejesës, se do më duhet më vonë. Do shkoj një herë nga fshati tjetër

për të parë për ndonjë vajzë tjetër.”

Bibla thotë se, në fshehtësi, donte ta prishte fejesën pa e turpëruar para të gjithëve sepse e donte shumë, nuk donte ta turpëronte, por donte ta ndërpriste këtë fejesë sa më parë. Ja si thuhet:

**Mateu 1:19-20** *'Atëherë Jozefi, i fejuari i saj, i cili ishte njeri i drejtë dhe nuk donte ta poshtëronte botërisht, vendosi ta linte fshehtas. Por, ndërsa bluante me vete këto çështje, ja që iu shfaq në ëndërr një engjëll i Zotit dhe i tha: "Jozef, bir i Davidit, mos ki frikë ta marrësh me vete Marinë si gruan tënde, sepse ç'është ngjizur në të është vepër e Frymës së Shenjtë.'*

Po ti vetë, nga cili provim ke më shumë frikë?  
Çfarë thonë të tjerët apo çfarë thotë Perëndia?

Bibla thotë, frika për atë që mendojnë të tjerët është lak.

Në momentin që fillon të mendosh se çfarë thonë të tjerët, ka për të të rrëshkitur nga dora plani i Perëndisë dhe të tjerët do ta orientojnë jetën tënde.

Perëndia ka plane për ty, por edhe të tjerët kanë plane për jetën tënde. Cilin plan do të ndjekësh? A do të bësh atë që i pëlqen Perëndisë apo atë që u pëlqen të tjerëve?

Nëse Jozefi do e kishte patur mendjen gjithë kohën se çfarë thonë të tjerët, do të kishte humbur gjënë më të madhe të jetës së tij. Do e kishte ndarë Marinë dhe nuk do kishte qenë ai personi që do rriste në familjen e tij Jezusin, Birin e Perëndisë.

Por ai tha: Puna e madhe çfarë mendojnë të tjerët. **Unë do bëj atë që i pëlqen Perëndisë.**

Edhe barinjtë u përballën me shqetësimet e tyre.

### **Shqetësimet që Vijnë nga Një Ndryshim i Shpejtë**

Ndryshim i madh dhe i menjëhershëm. Ata po ruanin delet. Barinjtë i marrin gjërat lehtë në përgjithësi. *Sot i kullosim delet këtu, nesër atje.* Puna e tyre nuk është se ka shumë ndryshime të mëdha.

Ishte natë, delet janë qetësuar, kanë ndezur një zjarr. Ka mundësi që ndonjëri ka marrë ca gështenja dhe po i pjekin në prush, ca patate dhe e kanë vënë

bukën të theket afër prushit. Ca djathë dhe një teke raki. Po mendoj për barinj të fshatit tim, se nuk janë këto detaje në Bibël.

Dhe në mes të qetësisë, një dritë e madhe ndriçoi qiellin.

Pastaj u shfaq një kor i madh, një grup i madh engjëjsh. Ata s'kishin parë engjëj ndonjëherë dhe kjo i frikësoi për vdekje. Dritë e madhe, një grup i madh engjëjsh.

Planet e tyre për një natë të qetë u prishën, ndodhi një ndryshim i menjëhershëm dhe drastik.

**Luka 2:8-10** *'Tani në po atë krahinë ishin disa barinj që rrinin jashtë, në fusha, dhe natën ruanin kopenë e tyre. Dhe ja, një engjëll i Zotit iu paraqit atyre dhe lavdia e Zotit shkëlqeu rreth tyre e ata i zuri një frikë e madhe. Por engjëlli u tha atyre: "Mos druani, sepse unë po ju lajmëroj një gëzim të madh për të gjithë popullin;'*

Sot je këtu, nesër je në Greqi, Itali. "Po, nga vendoset kaq shpejt?" Po, ja ashtu, po pinim kafën në mëngjes dhe thamë, "A ikim?" "Po mirë, ikim." Ka ndonjë që i ka qejf ndryshimet bam bam?

"Do e lë punën." "Po mirë, lëre." "A martohemi, jemi që jemi?" "Po mirë, martohemi." "A e nisim një fëmijë?" "Po mirë." "A e blejmë një shtëpi?" "Po mirë, marrim një kredi nesër."

Edhe pse kam vite që e njoh Perëndinë, prapë se prapë, kur Perëndia shfaqet dhe të flet ashtu befas: "Bëj këtë, mos bëj atë, mos lëviz kështu por shko nga ajo ana tjetër," më frikëson ndryshimi i menjëhershëm.

Por ty: Çfarë është një gjë që të ka thënë Perëndia dhe akoma nuk e ke bërë sepse të frikson ndryshimi i menjëhershëm dhe po pret dhe nja 2000-3000 shenja të tjera që të bindesh mirë që është ashtu?

Kështu u ndodhi barinjve: iu shfaq Perëndia dhe ata duhet të ndryshonin planet që kishin. Por Perëndia nuk do të na frikësojë, prandaj thotë kaq shpesh "Mos ki frikë."

Edhe mbreti Herod u mbush me merak dhe frikë kur lindi Jezusi. Herodi kishte merak mos i merrte pushtetin. Thuhet që ai ishte aq frikacak dhe paranojak për pushtetin, sa që vrau kunatin, të ëmën, gruan dhe dy fëmijët.

Tmerrohej fare kur dëgjonte se dikush mund t'i kërcënonte pushtetin.

Kur mori vesh që ka lindur një mbret në Izrael, atij po i pushonte zemra nga frika që dikush mund t'i merrte pushtetin.

**Mateu 2:3** *'Mbreti Herod, kur dëgjoi këto fjalë, u shqetësua, dhe bashkë me të mbarë Jeruzalemi.'*

Dhe po e gjetët çfarë bëri Herodi? Ate që bënte gjithmonë: urdhëroi vrasje për çdo foshnje djalë nga dy vjeç e poshtë për të eliminuar kërcënimin.

Por një engjëll iu shfaq Jozefit dhe Marisë dhe iu tha të iknin në Egjipt. Dhe Jezusi u rrit në vitet e para të fëmijërisë në Egjipt dhe nuk u kthyen në Izrael derisa vdiq Herodi.

Krishtlindja e parë ishte ndryshe nga festimi i Krishtlindjes sot. Ne këndojmë "Natë e qetë, Natë e shenjtë," flasim për dashuri, qetësi, paqe, sa bukur, sa mirë, çfarë gëzimi, drita, pemë, ndriçim, dhurata, njerëz ...

Por nuk kishte aq qetësi dhe aq paqe atë natë. Të gjithë u shqetësuan, u frikësuan për Krishtlindje: Maria, Jozefi, barinjët, Herodi, gjithë Jeruzalemi...

## **Cila nga këto frikëra po të pengon ty?**

### **Frika që S'jam Personi i Duhur**

Kjo frikë ndonjëherë është aq e madhe sa thua: "Unë as që do e provoj këtë gjë sepse e di që s'do t'ia dal dot. S'jam aq i zgjuar, s'jam aq i zoti, s'kam aq shokë, s'jam aq e bukur, s'kam aq shumë lekë."

### **Frika se Çfarë Mendojnë të Tjerët**

Ti e ke vdekje kur të kritikojnë. Më mirë bëhesh i mirë me të gjithë, se sa të dëgjosh kritika. Dhe përfundon duke e mbajtur mirë me të gjithë, që askush të mos të kritikojë.

Sekret: Nëse nuk e ke marrë aprovimin e të tjerëve deri tani, s'ke për ta marrë asnjëherë.

Pjesa e Bukur: Nuk të duhet aprovimi i të tjerëve për të qenë i lumtur. Ti nuk



ke nevojë për aprovimin e dikujt që të jesh i lumtur apo të ecësh përpara.

### **Frika e Ndryshimit të Menjëhershëm**

Disa nga ju kanë frikë ndryshimin. Dëshiron që në vitin që po vjen të mos ndryshojë gjë, të jetë si viti që lamë pas. E di çfarë? E vetmja gjë që ndryshon gjithmonë është ndryshimi, do apo s' do ti.

Nëse të streson ndryshimi, do jesh i stresuar gjithë kohës, sepse çdo ditë, çdo javë, çdo muaj, ka ndryshime dhe duhet të ketë ndryshime.

### **Frika se Mos Humbas Kontrollin e Gjërave**

Edhe kjo është e madhe. *Ej, të mos i fusë njeri as duart as hundët te punët dhe planet e mia.*

E di se ku kuptohet që po të dalin gjërat jashtë kontrollit? Kur shqetësohesh shpesh.

Shqetësim do të thotë: po më dalin gjërat nga kontrolli. Ti po luan rolin e Perëndisë. Po gënjen veten që mund t'i kesh gjërat në kontroll. Nuk je ti në kontroll, është Perëndia.

Kontrolli tregon pasiguri. Sa më shumë pasiguri ke aq më kontrollues bëhesh.

Kur takon këtë personin që është kontrollues, paragjykues, të vjen t'i thuash: "Shoku, ti s'kontrollon dot veten tënde, familjen tënde, jo më të kontrollosh të tjerët." Edhe vetja na del nga kontrolli ndonjëherë, jo më të pretendojmë se do kontrollojmë të tjerët.

Sa më shumë frikëra dhe pasiguri kam, aq më kontrollues bëhem.

Kur e shikon që po bëhesh i tillë, pyete veten: "Çfarë frike kam? Çfarë po më shqetëson?" dhe e gjen kollaj kur e pyet veten sinqerisht.

### **Frika e Zhgënjimit**

"Nuk guxoj të filloj diçka të re sepse dështova një herë dhe s' dua të zhgënjehem më. Nuk do të hedh më hapa besimi. Kam frikë që të shpresoj

prapë, se mund të zhgënjehem prapë. S' do lejoj më asnjë gocë të ma thyejë zemrën, më mirë rri beqar gjithë jetën. S' do lejoj më asnjë djalë të më lëndojë kaq shumë, më mirë rri beqare gjithë jetën.”

E vërteta është: Të gjithë do hasim zhgënjime sepse s'ka asnjë të përsosur në këtë botë.

### **Me cilën nga këto frikëra ke qenë duke u përballur ti vetë ose i sheh që po përballen të tjerët rreth teje?**

Nëse po kalon ndonjë nga këto frikëra, kjo është dita jote për t'u çliruar nga ato, sepse Perëndia dëshiron të jetosh i lirë, pa to. Hapa praktike:

### **Dorëzoja Jetën Tënde Perëndisë ÇDO DITË**

"Zot, ndjej frikë, dua ta lë para Teje çdo gjë: të mirat, të këqijat, të bukurat, të shëmtuarat e jetës time, çdo gjë." Kështu u mor Maria me frikërat e veta, kur engjëlli i tha asaj të gjitha lajmet se çfarë do ndodhte.

**Luka 1:38** *'Atëherë Maria tha: "Ja shërbëtorja e Zotit; le të më ndodhë sipas fjalës sate". Dhe engjëlli u largua prej saj.'*

**Unë i dorëzohem Perëndisë, Ai e di më mirë se ç'po bën, më mirë sa di unë.**

A i ke thënë ndonjëherë Perëndisë këtë gjë: **Ti je Perëndia im, ti je Krijuesi im, bëj me jetën time siç do Ti.**

Nëse s'e ke thënë, po jeton në tension të vazhdueshëm që prodhojnë frikëra dhe shqetësime.

**Pra, e para si t'i mposhtësh frikërat:** Çdo ditë bëj një pauzë dhe dorëzoja jetën, frikërat, dyshimet, çdo gjë Perëndisë, lutu dhe bisedo me Të.

### **Mos i dëgjo zërat frikësues**

Mos e ushqe mendjen me gjëra që kanë faktor frike.

Rreth e qark teje ka shumë njerëz negativë. Çfarë është më e lehtë sot, të jesh pozitiv apo negativ?

Frika është ngjitëse, është si puna e gripit. Nëse rri me njerëz të frikësuar dhe të shqetësuar gjithë kohës, po e gjete si do bëhesh ti?

Nëse rri me njerëz zemërakë, që kanë inat me të gjithë, të gjithë janë të këqij, si do bëhesh ti?

Rri me njerëz si ti. Pije kafen me këta çuna/goca që kanë mendësi si ti. Fillo një grup të vogël.

### **Mbushu me Muzikë që Lavdëron Perëndinë**

Lavdërimi është ilaçi i panikut. Kur ke frikë, ndodh sepse po fokusohesh te vetja: *çfarë kam bërë, çfarë s'kam bërë, sa i zoti jam, sa kot jam.*

POR kur lavdëron, dëgjon muzikë dhe fokusi nuk është më tek ty por te Perëndia: kush është Ai, sa i mirë është Ai, çfarë mund të bëjë Ai.

**Luka 1:46-49** *'Dhe Maria tha: "Shpirti im e madhëron Zotin, dhe fryma im ngazëllon në Perëndinë, Shpëtimtarin tim, sepse ai e shikoi me pëlqim ultësinë e shërbëtores së tij; sepse ja, tani e tutje të gjitha brezat do të më shpallin të lume, sepse i Pushtetshmi më bëri gjëra të mëdha, dhe i Shenjtë është emri i tij!"*

Nuk është rastësi që në muajin e Krishtlindjes ka më shumë këngë sa çdo muaj tjetër.

Maria këndoi, barinjte kënduan, engjëjt kënduan.

Dëgjo muzikë që largon frikërat. Muzika të ndihmon të fokusohesh te Perëndia. Muzika që të kujton se kush është Perëndia, kush je ti për të dhe çfarë ka bërë Ai për ty.

### **Sugjerime për Muzikë dhe Playlist:**

- Pyet çunat ose gocat e bandës për sugjerime të mira.
- Bëj playlist në Spotify apo në një app tjetër.
- Bëj save që ta dëgjosh kur shkon për punë, kur je te stacioni i autobusit, në autobus, sa herë që ke kohë bosh.

Efektet e muzikës: Muzika largon tensionet, frikërat, dyshimet dhe të fokuson te Perëndia.

E fundit, si t'i mposhtësh frikërat:

## **Do e Vendos Shpresën te Premtimet e Perëndisë**

Çfarë do të të japë shpresë ty në vitin që po vjen?

Vendose shpresën tënde te ky libër, Bibla. Aty ka mbi 7 mijë premtime të Perëndisë për ty.

Nëse je i mbushur me frikë, ka shumë mundësi që ke harruar ta mbushësh veten me Fjalën e Perëndisë. Aty ka premtime për çdo zonë të jetës tënde, për të shkuarën, të sotmen, të ardhmen.

**Luka 1:45** *'Tani, e lum është ajo që besoi, sepse gjërat që i janë thënë nga ana e Zotit do të realizohen!'*

Kjo i dha konfidence dhe siguri kësaj vajze të re. Ajo besoi që Perëndia do e mbajë fjalën dhe kur Ai thotë diçka, do e bëjë. Kjo qoftë konfidence jote në këtë vit që po vjen, premtimet e Perëndisë për ty.

Merr një Bibël dhuratë nga ne, nëse nuk e ke një.

Perëndia erdhi në botë për ty. Erdhi në një formë që ne ta njihnim, ta kuptonim. Ai erdhi të na shpëtojë, të heqë shqetësimet, frikërat tona, të na sigurojë ne. Të pastrojë të shkuarën, të japë qëllim për të sotmen dhe të sigurojë përjetësi.

Ai të njeh, Ai të do, Ai të çmon pamasë!

**Le të lutemi.**

**Lutja e shpëtimit.**